



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Odeljenje za Zdravstvo i Socijalno Osiguranje

Odeljenje za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu

Department of Health and Social Welfare

-VI- Nr. i prot. 126 Më
Br. prot. 26.09.2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

**RAPORTI TRE (3) MUJOR I PUNËS SË DREJTORISË PËR SHËNDETËSI DHE
MIRËQENIE SOCIALE**

2019

Drejtori i DSHMS-~~u~~

Samir Mustafa

Rahovec, Prill 2019

Hyrje

Raporti tre mujor -2019, i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Rahovec, paraqet punën, zhvillimin dhe të arriturat kryesore të Drejtorisë dhe stafit të saj. Përmes këtij raporti, DSHMS paraqet detyrat dhe të arriturat drejt realizimit të planit të saj të punës si dhe detyrat tjera që dalin sipas detyrës zyrtare për të ofruar shërbime sa më cilësore për qytetarët e komunës së Rahovecit .

DSHMS-ja bashkëpunon dhe mbështet organizata joqeveritare të cilat janë të gatshme për bashkëpunim, ku kemi pasur suksese në të gjitha fushat duke ndihmuar në realizimin e qëllimit të përbashkët kundrejt qytetarëve të komunës tonë.

Caktimi i prioriteteve të punës dhe përcjelljen e nevojave sociale, shërbimeve shëndetësore ka qenë punë e përditshme e tre mujori të parë të 2019 DSHMS-së dhe stafit të saj.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Aktivitetet e DSHMS-së për periudhën raportuese të tre mujorit të parë të 2019 janë:

- Konsultimet dhe takimet e rregullta me stafin, Drejtorin e QPS-së dhe QKMF-së në Rahovec.
 - Përpilimi i raporteve javore, mujore të punës për vitin 2019, dhe krijimi nevojës për raportim të vazhdueshëm.
 - Angazhimi rreth përmirësimit të kushteve për punë të nëpunësve dhe stafit në përgjithësi në kuadër të DSHMS-së.
 - Shqyrtimi dhe përgjigjja me kohë të kërkesave të ndryshme të qytetarëve, si dhe të atyre për ndihmë momentale-financiare.
 - Pjesmarrja aktive në kolegjiunin e drejtorëve të DSHMS-së, në cilësin e anëtarit të kryesisë në kuadër të Asociacionit të Komunave.
-

Në fillim të Janarit kemi aplikuar me dy projekte për grande në AQH, një projekt për kasetat, për vendosje të kartelave shëndetësore, dhe një projekt për dixhitalizim të Rentgenit, ku projektin për vendosje të kartelave shëndetësore kemi fituar me vlerën prej 12.000€, po ashtu kemi fitu edhe një doacion nga KFORI Italian, paisje mjekësore 2 EKG, për nevoajt e QKMF, si dhe stetoskopak për mjekë pediatër.

Takime të rregullta me grupin punues për hartim të **master planit në shëndetësi** në komunën e Rahovecit, ku me asistencën AQH-së, pas dëgjimeve publike me qytetarët të aprovohet në kuvendin komunal, një planë i detajuar që i plotëson nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të komunës së Rahovecit për shërbime primare shëndetësore.

Kemi nënshkruar kontratën me Caritas Kosova për ofrimin e shërbimeve mjekësore, shërbimi “Home Care” për personat në regjim shtrati, dhe për personat në nevojë, vlera e kontratës 194.398€, ku janë punësuar 48 punëtor shëndetësor dhe 5 pedagog dhe psikolog.

Në fillim të muajit Marrs kemi vazhduar me fushatën për vetëdijesimin e popullatës, fushatën senzibilizuese kundër “Etheve Hemoragjike Krime Kongo-Riqnave” po ashtu fushata dhe ligjeratat janë mbajtur në të gjitha shkollat e komunës së Rahovecit.

Qeverisë së Kosovës përkatësisht ministrive gjegjëse, i jemi drejtuar me kërkesat për ndihmë të projekteve në DSHMS.

Po ashtu kemi vazhduar me rekrutim të stafit shëndetësor në QKMF, për ti ofruar sa më shumë shërbime për qytetarët në nevojë, janë avancuar shërbime stomatologjike në dy QMF-të, në Drenoc dhe Fortesë, ku janë angazhuar stomatolog permanent në këto dy QMF-të.

Investimet kapitale në DSHMS, janë duke vazhduar sipas planit të prokurimit, të hartuar në fillim të vitit.

Sfidat e DSHMS

Si drejtori ballafaqohemi me sfidat, ndër sfidat kryesore për DSHMS, janë funksionalizimi i repartit të hemodializës që është njësi satelite e spitalit regjional të Prizrenit, ne si drejtori i kemi kryer obligimet në investime, ndërsa për funksionalizim të dializës është kompetenc dhe detyrë e spitalit të Prizrenit, po ashtu sfid e DSHMS është edhe përfundimi i objektit të **QKMF-së, dhe emergjencës** që dot na krijojë kushte dhe hapsira të volitshme për punë stafit mjekësor.
